

Financuar nga:



## NJOFTIM PËR EKSPERT PËR ZHVILLIM METODOLOGJIE

<b>Kontraktues:</b>	CBS Creative Business Solution
<b>Tipi i kontratës:</b>	Kontratë Shërbimi
<b>Kohëzgjatja:</b>	15 ditë pune ( <i>e shtrirë në 4 muaj</i> )
<b>Referenca e linjës buxhetit:</b>	6.1
<b>Data e publikimit:</b>	16.03.2018
<b>Afati i aplikimit:</b>	22.03.2018

### Informacion i përgjithshëm

Creative Business Solutions po zbaton projektin “*Monitorimi i Performancës së Bashkisë Dibër & Ndërgjegjësimi Komunitar për Pjesëmarrje*” i cili mbështetet në kuadër të projektit PACT të financuar nga Bashkimi Evropian, Delegacioni në Shqipëri dhe zbtuar nga ANTTARC në partneritet me ALCDF dhe AfS. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në promovimin e qeverisjes së mirë, transparencën e shpenzimeve publike dhe pjesëmarrjen aktive të publikut në praktikën e ndershme dhe shpenzimet efikase publike në nivel lokal në Shqipëri. Projekti i cili është në fazë zbatimi, si pjesë të ndërhyrjes së tij parashikon “Rritjen e Kapaciteteve në rolin Monitorues” të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile dhe krijimin e infrastrukturës për ndërgjegjësim publik. Kjo do të realizohet nëpërmjet zhvillimit të një workshop-i me synim ndërgjegjësimin qytetar.

### Qëllimi i Njoftimit dhe Përshkrimi i punës

Kjo kërkesë i drejtohet ekspertëve të kualifikuar dhe me eksperiencë në zbatimin e aktiviteteve me fokus në qeverisjen e mirë dhe transparencën e shpenzimeve publike. Eksperti do të mbështesë teknikisht projektin dhe do të angazhohet gjatë zhvillimit të Workshop-it duke përfshirë dizajnimin e konceptit dhe takime të parashikuara me përfaqësues të Bashkisë Peshkopi dhe Shoqërisë Civile. Gjithashtu, eksperti mbështet në realizimin e suksesshëm të workshop-t duke dhënë kontribut aktiv në hartimin e pyetësorit të dedikuar për qytetarët dhe NVM-të për zhvillimin e anketës në terren. Në përfundim eksperti përpilon dhe dorëzon një raport përmbledhës. Eksperti i përzgjedhur mund të kryejë disa udhëtime jashtë Tiranës.

Financuar nga:



### Kriteret e vlerësimit

Të gjitha aplikimet do të vlerësohen në mënyrë të barabartë dhe në fshehtësi të plotë. Kriteret e përzgjedhjes janë si më poshtë:

	%
<b>Kërkesa Teknike</b>	<b>80</b>
Eksperienca e mëparshme	20
Përvojë në zhvillimin e aktiviteteve për qeverisjen e mirë dhe transparencën	25
Përvojë në moderimin dhe konceptimin e workshop-ve	20
Kapaciteti për dorëzimin e punës në kohë	15
<b>Intervista</b>	<b>20</b>
<b>Totali</b>	<b>100</b>

### Mënyra e pagesës

100% pas zbatimit të suksesshëm të detyrave të paracaktuara dhe me dorëzimin e raportit final;

### Aplikimi

Kandidatët e kualifikuar dhe të interesuar duhet të dorëzojnë në e-mail [info@cbs.al](mailto:info@cbs.al) një CV të shoqëruar me një letër të shkurtër motivimi jo më vonë se data 22/03/2018, duke përfshirë "Ekspert për zhvillim metodologjie" në subjekt të e-mail. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen. Megjithatë, të gjithë aplikuesit do të marrin një përgjigje.

### Rreth CBS

Creative Business Solution, është një organizatë konsulence biznesi, jo fitim-prurëse me ekspertizë të theksuar në fushën e konsulencës financiare, financimin e sektorëve në zhvillim, asistencës teknike dhe zbatimin e projekteve zhvillimore me impakt të gjerë në zhvillimin ekonomik. Përmes veprimtarisë së saj CBS zbaton projekte komplekse në Shqipëri me ndikim edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. CBS ofron shërbime të vlefshme dhe efektive duke gjeneruar rritje ekonomike për bizneset, në sektorët e zhvillimit të ekonomisë, bujqësi, energji të pastër, turizëm etj. Ekipi i CBS numëron rreth 35 punonjës, të cilët operojnë në zyrat qendrore në Tiranë si dhe katër degë lokale në Fier, Korçë, Gjirokastër dhe Peshkopi. CBS është partner zyrtar me USAID dhe ka marrëdhënie institucionale me organizata donatore ndërkombëtare. Gjithashtu, CBS ka bashkëpunim të ngushtë me bankat komerciale më të mëdha në vend dhe institucionet financiare, marrëdhënie aktive me mbi 400 SME dhe bashkëpunim me institucionet qeveritare.

Site zyrtar: [www.cbs.al](http://www.cbs.al)